

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ADB IMPIANTI SHPK

Sot, më 01/03/2022, subjektet e mëposhtme, nëpërmjet këtij dokumenti, themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe me këtë akt:

- *ADB IMPIANTI SRL, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin italian, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Brescias, Dhoma e Tregtisë, Industrisë, Zejtarisë dhe Bujqësisë, më datë 10.11.2016, me nr. 03858100989, dhe seli në adresën: Travagliato (BS) Via Dell'Industria 62-64 CAP 25039, Brescia, Itali, e përfaqësuar nga z. Arven Brami dhe z. Dritan Brami;*
dhe
- *z. Olsi Shtylla, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 15/06/1975, mbajtës i pasaportës me nr. H50915004I;*

Neni 1

Emërtimi

Nëpërmjet këtij akti rregullohet organizimi dhe funksionimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, e emërtuar **ADB IMPIANTI Shpk** (në vijim referuar si "**Shoqëria**").

Neni 2


Forma juridike

ADB IMPIANTI Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në veçanti me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: *Rruga "Margarita Tutulani" Pallati nr. 19, Hyrja 2, Kati 3, Ap. 9, Tiranë, Shqipëri.*
- 3.2 Administratorët mund të hapin dhe/ose mbyllin filiale, degë, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat e këtij dokumenti dhe të legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

- 5.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si vijon:
 - a) Realizimi i specifikimeve, inxhinieria bazë dhe e detajuar për elektrifikimin e impianteve dhe makinerive (diagramet e instalimeve elektrike, specifikimet, projektet dhe manualët e funksionimit), hartimi i specifikimeve dhe zhvillimi i softuerit (niveli 1 dhe 2), vënia në punë dhe marketingu përkatës;
 - b) Pajisjet dhe sistemet elektrike, mekanike, elektromekanike, elektronike;
 - c) Montimi dhe instalimi i pajisjeve industriale elektrike;
 - d) Instalimi i instrumenteve dhe pajisjeve të matjes, kontrollit, testimit, navigimit, e të ngjashme (përfshirë pajisjet e kontrollit të procesit industrial) - montimi i pajisjeve të kontrollit të procesit industrial;
 - e) Prodhim i pajisjeve të tjera të instalimeve elektrike - prodhimi i zbarave, përçuesve elektrikë - prodhimi i GFCl-ve (ndërprerësve të qarkut të shkurtër në tokë) - prodhimi i mbajtësve të llambave-prodhimi i rrufepritësve - prodhimi i celsave për qarqet elektrike (p.sh. butona, çelsat e shpejte, cilindrat) - prodhimi i prizave elektrike - prodhimi i mbylljeve për qarqet elektrike (p.sh. lidhjet, prizat, kutitë e celsave) - prodhimi i kanaleve elektrike dhe aksesoreve - prodhimi i kanaleve të transmetimit, përbërësve dhe aksesoreve të linjës;
 - f) Instalimi i sistemeve elektrike në ndërtesa ose punime të tjera ndërtimi (përfshirë mirëmbajtjen dhe riparimin) - instalimi i sistemeve elektrike në të gjitha llojet e ndërtesave dhe në strukturat e inxhinierisë civile: instalime dhe lidhje elektrike, sisteme ndriçimi - instalimi i sistemeve të lidhjes së pajisjeve shtëpiake dhe elektroshtëpiake - montimi i sistemeve fotovoltaike.
- 5.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të realizohet objekti i sipërpërmendur, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënieje, hipotekor ose pengu.
- 5.3 Shoqëria, me qëllim investimin e kapitalit të saj, mund të ketë interesa dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera, konsorciume, etj., që kanë objekte veprimtarie të çdo lloji, të ngjashme ose të lidhura me objektin e veprimtarisë e saj.

- 5.4 Pavarësisht sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të dobishëm ose të nevojshëm të lejuar nga ligji në fuqi për realizimin e objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 6

Kapitali

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 10.000,00 euro (*dhjetë mijë euro*).
- 6.2 Kapitali themeltar i nënshkruar i Shoqërisë është i përbërë prej 2 (dy) kuota, në përputhje me nenin 7.
- 6.3 Kapitali themeltar i Shoqërisë apo çdo kontribut në para për rritjen e kapitalit do të paguhet në llogarinë bankare të Shoqërisë.
- 6.5 Kontributi i ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë do të jetë në para dhe/ose në natyrë, në formën e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme dhe/ose në formën e të drejtave.

Neni 7

Ortakët

Ortakët e Shoqërisë janë:

- **ADB Impianti SRL**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin italian, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Dhomës së Tregtisë, Industrisë, Zejtarisë dhe Bujqësisë së Brescia-s, në datë 10.11.2016, me nr. regjistrimi 03858100989, dhe seli në adresën Travagliato (BS) Via Dell'Industria 62-64 cap 25039, Brescia, Itali, zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 90 % (nëntëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar në shumën prej 9.000,00 euro (nëntë mijë euro).
- **z. Olsi Shtylla**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 15/06/1975, mbajtës i pasaportës me nr. H50915004I, zotërues i 1 (një) kuote që i korrespondon 10 % (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar në shumën prej 1.000,00 euro (një mijë euro).

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose më shumë këste, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas shumicës së parashikuar në Nenin 11 të Statutit.
- 8.2 Në rast të zmadhimit të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë një pjesë të kapitalit të zmadhuar në përpjesëtim me vlerën e kapitalit të zotëruar prej tyre.
- 8.3 Nuk mund të bëhet asnjë zmadhim tjetër kapitali, në rast se nuk janë paguar plotësisht kontributet për zmadhimin e mëparshëm.

- 8.4 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e 100 lekë (njëqind lekë), që është minimumi i vlerës së kërkuar nga ligji.

Neni 9

Transferimi i kuotave dhe e drejta e parablerjes

- 9.1 Dispozitat e këtij neni synojnë të mbrojnë interesat e Shoqërisë, unitetin e ortakëve dhe të ruajnë ekuilibrin e marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe për këtë arsye vendosen kufizimet e mëposhtme, në rast transferimi të kuotave.
- 9.2 Kuotat janë lirisht të transferueshme: (i) ndërmjet ortakëve, (ii) ndërmjet ortakëve dhe shoqërive të kontrolluara nga ortakët e shoqërisë dhe/ose shoqëritë kontrolluese në zotërim të ortakëve të shoqërisë.
- 9.3 Kuotat janë lirisht të transferueshme me testament dhe/ose trashëgimi ligjore.
- 9.4 Për çdo formë transferimi të kuotave (përfshirë transferimin pa kompensim) te persona të ndryshëm nga ata të specifikuar në pikën 9.2 më sipër, ortakët ekzistues të shoqërisë do të kenë të drejtën e parablerjes mbi kuotat e planifikuara për t'u transferuar, në përputhje me rregullat e cituara në dispozitat e mëposhtme.
- 9.5 Ortaku, i cili synon të shesë ose transferojë kuotën e tij, duhet të njoftojë me shkrim ("Njoftim") Administratorin në adresën e selisë së shoqërisë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat personale të transferuesit të kuotave dhe blerësit të tyre, kuotën që do të transferohet, kushtet e transferimit, duke përfshirë çmimin dhe mënyrat e pagesës.
- 9.6 Administratori, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e Njoftimit për transferimin, do të njoftojë ortakët e Shoqërisë për transferimin në fjalë.
- 9.7 Ortakët, të cilëve u drejtohet Njoftimi, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotën e përmendur në Njoftim duke i dërguar ortakut ofrues dhe Administratorit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e Njoftimit, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.
- 9.8 Në rast se ortakët e tjerë dhe ortaku transferues nuk bien dakord për çmimin e kuotës së propozuar nga ky i fundit, ose për vlerën e tregut në rast transferimi pa kompensim, ata caktojnë një ekspert për të përcaktuar çmimin sipas vlerës së tregu, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Pas shpalljes së çmimit të blerjes së kuotës së përcaktuar nga eksperti, ortakët, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh duhet të njoftojnë Administratorin dhe ortakun transferues për interesin e tyre për të blerë kuotën me çmimin e përcaktuar nga eksperti.
- 9.9 Në rast të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga më shumë se një ortak, kuota e ofruar do të ndahet ndërmjet ortakëve të interesuar në përpjesëtim me pjesëmarrjen që secili ka në kapitalin e Shoqërisë.

- 9.10 Nëse një ose disa nga ortakët që kanë të drejtën e parablerjes nuk e dëshirojnë ose nuk mund ta ushtrojnë këtë të drejtë, e drejta e tyre e parablerjes transferohet automatikisht dhe në proporcion të ortakët e tjerë.
- 9.11 Nëse asnjë nga ortakët nuk synon të blejë kuotën e ofruar sipas afateve dhe kushteve të përshkruara në këtë Statut ose nëse asnjë nga ortakët nuk njofton brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ortaku transferues do të jetë i lirë t'ia transferojë kuotën blerësit të specifikuar në Njoftimin e dërguar ortakëve të tjerë. Transferimi do të konsiderohet i miratuar në heshtje nëse ortaku transferues nuk njoftohet për ushtrimin e së drejtës së parablerjes brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ose kur nuk arrihet marrëveshje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të transferimit në fjalë nga ortaku transferues.
- 9.12 Në rast se një ose të gjithë ortakët e tjerë fitojnë të drejtën e transferimit të kuotës sipas kushteve të ofertës dhe procedurës së përcaktuar më sipër, ky transferim duhet të kryhet në përputhje me kushtet e ofertës.
- 9.13 E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë kuotën e ofruar.

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme

- 10.1 Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të atribuara nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, nga ky Statut dhe/ose nga çdo marrëveshjeje e veçantë e ortakëve, dhe veçanërisht për sa më poshtë:
- a. përcaktimin e politikës tregtare të Shoqërisë;
 - b. ndryshimin e statutit të Shoqërisë;
 - c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve, likuidatorit/ve dhe ekspertit/ëve kontabël të autorizuar të pavarur të Shoqërisë;
 - d. përcaktimin e shpërblimit për administratorin/ët e Shoqërisë, likuiduesin/ët dhe ekspertit/ëve kontabël të autorizuar të pavarur të Shoqërisë;
 - e. mbikëqyrjen e ekzekutimit të detyrave nga administratori/ët e Shoqërisë, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raporteve vjetore të menaxhimit;
 - f. miratimin e raporteve financiare vjetore dhe raportit vjetor të menaxhimit të Shoqërisë;
 - g. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - h. pjestimin dhe anulimin e kuotave të Shoqërisë;
 - i. përfaqësimin gjyqësor të Shoqërisë për pretendimet ndaj administratorit/ve të Shoqërisë;
 - j. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;

- k. çdo synim të ortakëve të Shoqërisë për të shitur, ose ndryshe për të transferuar 5% ose më shumë të aktiveve të Shoqërisë, siç vërtetohet në pasqyrat më të fundit financiare të Shoqërisë;
- l. çështje të tjera, të marra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.


Neni 11

Përfaqësimi dhe Kuorumi

- 11.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij/saj dhe të ushtrojë të drejtat e votës në përpjesëtim me pjesën e kapitalit që zotëron në shoqëri.
- 11.2 Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblesë të Përgjithshme nga një ortak tjetër dhe/ose nga një person i tretë i autorizuar me Prokurë të Posaçme. Prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin dhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.3 Përveç nëse parashikohet ndryshe nga ligji në fuqi dhe/ose ky akt, në rastin e vendimmarrjes kur kërkohet shumicë e thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 11.4 Në rast se kërkohet një shumicë e cilësuar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar, janë të pranishëm personalisht ose me përfaqësim, për të votuar, me shkrim ose me mjete elektronike.
- 11.5 Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, sic është përcaktuar në pikën 11.4 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Me të njëjtën shumicë, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë heqjen e ndalimit, të parashikuar në nenin 17 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" (ndalimi i konkurrencës). Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 11.6 Nëse ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme mbledhet për herë të dytë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga thirrja e parë me të njëjtin kuorum të kërkuar.
- 11.7 Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme do të drejtohet nga një kryetar i emëruar nga Asambleja. Për procesverbalin e mbledhjes, kryetari i mbledhjes cakton një sekretar, i cili nuk mund të jetë asnjë nga ortakët.
- 11.8 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme nënshkruhen nga të gjithë ortakët pjesëmarrës.

Neni 12

Njoftimi i Asamblesë së Përgjithshme



- 12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar për miratimin e pasqyrave financiare, si dhe kur kjo kërkohet me shkrim nga 1 (një) ose disa ortakë që zotërojnë të paktën 5% (pesë për qind) të vlerës së kapitalit të Shoqërisë (“Ortakët në Minorancë”). Nëse Administratori nuk e thërret Asamblenë e Përgjithshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga paraqitja e kërkesës së ortakëve në minorancë, këta të fundit kanë të drejtë ta thërrasin vetë Asamblenë e Përgjithshme, duke përcaktuar rendin e ditës, kohën dhe vendin e mbledhjes. në përputhje me procedurat e përcaktuara në dispozitat e mëposhtme.
- 12.2 Gjithashtu, Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet kur:
- i. sipas pasqyrave financiare vjetore ose raportet financiare të ndërmjetme, rezulton ose ekziston risku që të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve të ardhshëm;
 - ii. Shoqëria propozon të shesë, ose të transferojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5% (pesë për qind) të aktiveve të Shoqërisë, të rezultuara në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar;
 - iii. Shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak asete, të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5% (pesë për qind) e aktiveve të shoqërisë, të rezultuara në pasqyra financiare të certifikuar.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e Shoqërisë dhe/ose në çdo vend tjetër brenda dhe/ose jashtë Shqipërisë.
- 12.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim të dërguar me postë dhe/ose me postës elektronike drejtuar secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe do t'i dërgohet çdo ortaku, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Njoftimi duhet të përmbajë edhe mënyrën e pjesëmarrjes në mbledhje dhe/ose mënyrën e vendimmarrjes.
- 12.5 Njoftimi i mbledhjes mund të parashikojë një datë të dytë për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rast se mbledhja e parë nuk zhvillohet sipas njoftimit për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar në këtë Statut.
- 12.6 Njoftimi i mbledhjes me e-mail (e-mail), konsiderohet i marrë nga ortaku në datën/orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të njoftimit me e-mail.
- 12.7 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga personi i emëruar nga shumica e ortakëve pjesëmarrës (në vijim referuar si “Kryetari i Mbledhjes”).
- 12.8 Kryetari i Mbledhjes emëron sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.9 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike, si telekonferencë, videokonferencë, etj.

- 12.10 Përdorimi i mjeteve elektronike do të realizohet duke marrë të gjitha masat e nevojshme teknike për të garantuar identifikimin e ortakëve, si dhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme që:
- i. Kryetari i Asamblesë të ketë mundësinë të verifikojë dhe identifikojë ortakët që janë të pranishëm, të kontrollojë mbarëvajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe shpallë rezultatin e votimit;
 - ii. Sekretari të ketë mundësi të njihet me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhje, objekt i procesverbalit të mbledhjes;
 - iii. Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmëve në diskutimet për rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit të rendit të ditës.
- 12.11 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme në kushtet e përmendura në nenin 12.9 dhe vijues të këtij Statuti, konsiderohet e mbajtur rregullisht në vendin ku është i pranishëm Kryetari i Asamblesë dhe sekretari, i cili bën të mundur përgatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
- 12.12 Kryesuesi i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e secilit ortak pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.
- 12.13 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, si dhe diskutimet dhe komentet e ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga sekretari i mbledhjes. Gjithashtu, ky procesverbal duhet të identifikojë ortakët e pranishëm dhe të përfaqësuar, ose ortakët, të cilët kanë votuar me shkrim. Procesverbalin do të nënshkruhet nga të gjithë ortakët pjesëmarrës. Procesverbalin i bashkëlidhet edhe lista e ortakëve, të cilët kanë votuar, si dhe njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, të cilat ruhen në selinë ligjore të shoqërisë.
- 12.14 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mund të shqyrtojë në të njëjtën ditë të gjitha çështjet që janë për diskutim, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet të nesërmen pa pasur nevojë për njoftim të mëtejshëm.

Neni 13

Administrimi

- 13.1 Shoqëria mund të administrohet nga një apo disa administratorë.
- 13.2 Administratori i parë i *Shoqërisë*, i cili do të ketë një mandat prej 5(pesë) vitesh, është:
- **Z. Olsi Shtylla**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 15/06/1975, mbajtës i pasaportës me nr. H50915004I;
- 13.3 Administratori/ët do të emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.
- 13.4 Administratori/ët janë persona fizikë, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund



të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit të administratorit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Shoqëria mund të administrohet dhe përfaqësohet nga Administratori, i cili është përgjegjës për menaxhimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë ndaj palëve të treta, në përputhje me dispozitat e këtij dokumenti dhe legjislacionin në fuqi.
- 14.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorit në lidhje me menaxhimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen, në sa vijon:
 - i. të zbatojë politikat e biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - ii. të sigurojë përputshmërinë e Shoqërisë me ligjet dhe standardet e kontabilitetit;
 - iii. të kryejë të gjitha veprimet lidhur me menaxhimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
 - iv. të sigurojë mirëmbajtjen e rregullt të dokumenteve financiarë dhe kontabël të Shoqërisë;
 - v. të përfaqësojë Shoqërinë ndaj palëve të treta;
 - vi. të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
 - vii. të kryejë detyra të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë dokument.
- 14.3 Administratori/ët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj, ky statut ose vendime të Asamblesë së Përgjithshme i atribuohen Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.4 Çdo transaksion dhe/ose marrëveshje që përben ekspozimin e Shoqërisë për një shumë më të lartë se 5.000,00 Euro, përveç nënshkrimit të administratorit do të kërkojë miratimin/ratifikimin nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.5 Administratorët mund të delegojnë një pjesë ose të gjitha kompetencat e tyre personave të tjerë.
- 14.6 Në rast emërimi të 2 (dy) ose më shumë administratorëve, vendimi i Asamblesë së Përgjithshme mbi emërimin do të përcaktojë llojin dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave, të cilat mund të jetë veçmas ose bashkërisht.

Neni 15

Audituesi ligjor

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, auditimi i pasqyrave financiare dhe të regjistrave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një ose më shumë auditorëve ligjorë.

Neni 16

Viti financiar dhe pasqyrat financiare

- 16.1 Viti financiar fillon në datën 1 të muajit janar dhe përfundon në datën 31 të muajit dhjetor të çdo viti.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon në datën 31 të muajit Dhjetor.
- 16.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i administratorit dhe auditorit ligjor, nëse ka, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar.
- 16.4 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të bëhet çdo vit brenda 6 (gjashtë) muajsh nga përfundimi i vitit financiar.

Neni 17

Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme mund ta prishë Shoqërinë me vendim të saj. Prishja e Shoqërisë do të pasohet nga procedura e likuidimit.
- 17.2 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar kompetencat e tyre në përputhje me ligjet në fuqi.
- 17.3 Shoqëria do të vazhdojë të ekzistojë si person juridik për qëllime të likuidimit deri në përfundimin e procedurës. Gjatë kësaj procedure, formulimi "*në likuidim*" duhet të ndjekë emërtimin e Shoqërisë.

Neni 18


Shpërndarja e fitimit

Fitimet që rrjedhin nga pasqyra financiare vjetore do t'u shpërndahen ortakëve, përveç rasteve kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe.

Neni 19

Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 19.1 Ky dokument bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij do të kryhen në përputhje me legjislacionin shqiptar. Dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar, do të zbatohet për çështje që nuk rregullohen nga ky dokument.



19.2 Në rast se lindin mosmarrëveshje që lidhen me interpretimin ose zbatimin e këtij dokumenti, Gjykata e Rrethit Tiranë do të jetë kompetente për të zgjidhur çdo pretendim ose mosmarrëveshje.


Ky dokument është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën angleze dhe shqipe.

Z. Olsi Shtylla


OLSI SHTYLLA


NË EMËR TË ADB IMPIANTI SRL

Z. Arven Brami

Arven Brami


Z. Dritan Brami

Dritan Brami


**ARTICLES OF ASSOCIATION
AND
BYLAWS
OF
ADB IMPIANTI SHPK**

This day, on 01/03/2022, the following subjects, through this document, establish a limited liability company in accordance with the legislation in force of the Republic of Albania and with the present act:

- *ADB IMPIANTI SRL, a limited liability company, established and organized in accordance with the Italian legislation, registered with the Commercial Register of Brescia, Chamber of Commerce, Industry, Crafts and Agriculture, on 10.11.2016, with register no. 03858100989, and legal seat at the address: Travagliato (BS) Via Dell'Industria 62-64 CAP 25039, Brescia, Italy, duly represented by Mr. Arven Brami and Mr. Dritan Brami;*
and
- *Mr. Olsi Shtylla, Albanian citizen, born in Tirana, on 15/06/1975, holder of passport with no. H50915004I;*

Article 1

Denomination

Through this present act is regulated the organization and functioning of a limited liability company denominated **ADB IMPIANTI Shpk** (hereinafter referred to as the "**Company**").

Article 2

Legal Form

ADB IMPIANTI Shpk is a limited liability company, established and organized in accordance with the Albanian legislation and in particular with the provisions of the law no. 9901, dated 14.04.2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended and in compliance with this act.

Article 3

Registered Office

- 3.1 The legal seat of the Company shall be at the address: *Rruga "Margarita Tutulani" Pallati nr. 19, Hyrja 2, Kati 3, Ap. 9, Tirana, Albania.*
- 3.2 The Administrators may establish and/or close subsidiaries, branches, agencies and/or representation offices, by resolution of the General Assembly, either within or outside of the territory of the Republic of Albania.

Article 4

Duration

- 4.1 The Company shall perform its activity for an unlimited period of time, starting from the date of its registration with the Commercial Register, held by the National Business Center.
- 4.2 Dissolution and winding up of the Company shall be defined upon resolution of the General Assembly, according to the provisions of the present document and the legislation in force.

Article 5

Object of Activity

- 5.1 The Company shall have as its main business activity, the following:
 - a) Realization of specifications, basic and detailed engineering for electrification of plants and machinery (wiring diagrams, specifications, projects and operating manuals), drafting of specifications and software development (level 1 and 2), commissioning and related marketing;
 - b) Electrical, mechanical, electromechanical electronic equipment and systems;
 - c) Assembly and wiring of industrial electrical equipment;
 - d) Installation of measuring, control, testing, navigation and similar instruments and equipment (including industrial process control equipment) - assembly of industrial process control equipment;
 - e) Manufacture of other wiring equipment - manufacture of busbars, electrical conductors - manufacture of GFCIs (short-circuit breakers to earth) - manufacture of lamp holders - manufacture of lightning rods - manufacture of switches for electrical circuits (e.g. push-button, pushbuttons, snap switches, cylinders) - manufacture of electrical sockets - manufacture of enclosures for electrical circuits (e.g. splices, sockets, switch boxes) - manufacture of electrical conduits and accessories - manufacture of transmission channels, components and line accessories;
 - f) Installation of electrical systems in buildings or other construction works (including maintenance and repair) - installation of electrical systems in all types of buildings and in civil engineering structures: wiring and electrical connections, lighting systems - installation of connection systems of household appliances and electrical appliances - installation of photovoltaic systems.
- 5.2 In accordance with the Albanian legislation, in order to achieve the aforementioned scope, the Company may perform any commercial, financial, leasing, mortgage or pledge activity.
- 5.3 The Company, with the purpose of investing its capital, may own interests and participate in other companies, consortiums, etc., that have objects of activity of any kind, similar or related to the activity thereof.
- 5.4 Notwithstanding the foregoing, the Company may perform any useful or necessary activities permitted by the applicable law for the realization of its object of activity.

Article 6

Share capital

- 6.1 The share capital of the Company is EUR 10.000,00 (*ten thousand euros*).
- 6.2 The subscribed share capital of the Company is compound of 2 (two) shares, in accordance with Article 7.
- 6.3 The share capital of the Company and any contribution in cash for the increase of the share capital shall be paid in the bank account of the Company.
- 6.5 The contribution of the shareholder in the share capital of the Company shall be in cash and/or in kind, in the form of movable and/or immovable property and/or in the form of rights.

Article 7

Shareholders

The Shareholders of the Company are:

- *ADB Impianti SRL, a limited liability company, established and organized in accordance with the Italian legislation, registered with the Commercial Register of Brescia, Chamber of Commerce, Industry, Crafts and Agriculture, on 10.11.2016, with register no. 03858100989, and legal seat at the address Travagliato (BS) Via Dell'Industria 62-64 cap 25039, Brescia, Italy, owner of 1 (one) share equal to 90 % (a ninety percent) of the share capital in the amount of EUR 9.000,00 (nine thousand euros).*
- *Mr. Olsi Shtylla, Albanian citizen, born in Berat, on 15/06/1975, holder of passport with no. H50915004I, owner of 1 (one) share equal to 10 % (ten percent) of the share capital in the amount of EUR 1.000,00 (one thousand euros).*

Article 8

Increase and decrease of share capital

- 8.1 The share capital may be increased at any time, in one or more tranches, in accordance with the legislation in force, upon resolution of the General Assembly, pursuant to the majority provided in Article 11 of the Bylaws.
- 8.2 In case of a capital increase, all shareholders have the right to subscribe a portion of the increased capital in proportion to the value of the share capital owned by them.
- 8.3 No other capital increase may be made if the contributions for the previous increase have not been paid in full.
- 8.4 The Company may decrease the share capital, upon resolution of the General Assembly. In any case, the share capital cannot be reduced below ALL 100 (*one hundred Albanian Lek*), which is the minimum value required by law.

Article 9

Transfer of the shares and the right of pre-emption

- 9.1 The provisions of this article are intended to protect the interests of the Company, the unity of the shareholders and to maintain the balance of relations in between them, and for this reason, the following restrictions are set, in case of transfer of shares.
- 9.2 The shares are freely transferable: (i) in between the shareholders, (ii) between the shareholders and companies controlled by the company's shareholders and/or controlling companies owned by the shareholders of the company.
- 9.3 The shares are freely transferable by will and/or legal inheritance.
- 9.4 For any form of transfer of shares (including transfer without compensation) to persons other than those specified in point 9.2 above, the existing shareholders of the company shall have the right of pre-emption over the shares designed to be transferred, in accordance with the rules cited in the following provisions.
- 9.5 The shareholder, who intends to sell or transfer his share, must notify in writing ("Notice") the Administrator at the address of the headquarters of the Company. The notice must contain the personal data of the share transferor and their buyer, the share to be transferred, the terms of the transfer, including the price and methods of payment.
- 9.6 The Administrator, within 7 (seven) days, from the receipt of the Notice on the transfer, shall notify the shareholders of the Company regarding the transfer in question.
- 9.7 The shareholders to whom the Notice is addressed, must exercise the right of pre-emption over the share referred to in the Notice by sending to the offeror shareholder and to the Administrator, within 30 (thirty) days from the receipt of the Notice, the statement of exercise of the right of pre-emption.
- 9.8 In case, the other shareholders and the transferor shareholder do not agree on the share price proposed by the latter, or on the market value in case of share transfer without compensation, they shall appoint an expert to determine the price according to the value of the market, whose decision will be final. After the announcement of the purchase price of the share determined by the expert, the shareholders, within 15 (fifteen) days must notify the Administrator and the transferor shareholder about their interest in purchasing the share at the price determined by the expert.
- 9.9 In case of exercise of the right of pre-emption by more than one shareholder, the offered share will be divided among the interested shareholders in proportion to the participation that each holds in the capital of the Company.
- 9.10 If one or some of the shareholders having the right of pre-emption does not wish or cannot exercise this right, their pre-emption right is automatically and in proportion transferred to the other shareholders.
- 9.11 If none of the shareholders intends to purchase the share offered under the terms and conditions described in this Bylaws or if none of the shareholders notifies within 30 (thirty) days, the transferor shareholder will be free to transfer the share to the buyer specified in the Notice sent to the other shareholders. The transfer will be deemed to be tacitly approved if the transferor shareholder is not notified on the exercise of the right of pre-emption within 30 (thirty) days,

or when no agreement is reached within 60 (sixty) days from the date of notification of the said transfer from the transferor shareholder.

- 9.12 In case one or all of the other shareholders acquire the right to transfer the share according to the terms of the offer and the procedure defined above, this transfer must be carried out in accordance with the terms of the offer.
- 9.13 The pre-emption right must be exercised for the entire share offered.

Article 10

General Assembly

- 10.1 The highest decision-making body of the Company is the General Assembly. The General Assembly is entitled to resolve on all the issues attributed by the legislation in force in the Republic of Albania, this Bylaws and/or any separate Shareholders Agreement, and specifically on the following:
- a. determination of the commercial policy of the Company;
 - b. amendment of the Company Bylaws;
 - c. appointment and dismissal of the administrator/s, liquidator/s and authorized independent accountant/s of the Company;
 - d. determination of the remuneration for the Company administrator/s, liquidator /s and authorized independent accountant/s of the Company;
 - e. supervision of the execution of tasks by the Company administrator/s, including preparation of financial statements and of annual management reports;
 - f. approval of the annual financial reports and annual management report of the Company;
 - g. increase and reduction of the Company capital;
 - h. partition and annulment of Company shares;
 - i. court representation of the Company for claims against the Company administrator/s;
 - j. reorganization and dissolution of the Company;
 - k. any intention of the Company shareholders to sell or otherwise dispose of 5% or more of Company assets, as certified in the latest financial statements of the Company;
 - l. other matters, as resolved by resolution of the General Assembly.

Article 11

Representation and Quorum

- 11.1 Any shareholder is entitled to attend the meetings of the General Assembly, to represent its/his/her own opinion and exercise its/his/her voting rights in proportion to the capital share its/he/she owns in the Company.
- 11.2 The shareholders may be represented in the General Assembly by another shareholder and/or a third person authorized through the Special Power of Attorney. The Power of Attorney can be

given only for a meeting of the General Assembly, which includes the following meetings with the same agenda.

- 11.3 Except if otherwise provided by applicable law and/or this act, in the case of decision-making when a simple majority is required, the General Assembly shall decide validly when the meeting is attended by the voting shareholders, who own more than 30% (*thirty percent*) of the Company's share capital.
- 11.4 In case a qualified majority is required, the General Assembly may take valid resolutions only if the shareholders, owning more than half of the share capital are present in person or by representation, to vote, in writing or electronic means.
- 11.5 The General Assembly decides with three quarters of the votes of the participating shareholders, as defined in point 11.4 above, for the change of the bylaws, increase or decrease the registered share capital, distribution of profits, reorganization and dissolution of the company. By the same majority, the General Assembly may decide to remove the ban, provided for in Article 17 of the Law "*On Entrepreneurs and Companies*" (prohibition of competition). In all other cases, the General Assembly may take valid decisions by a majority vote of the participating partners.
- 11.6 If such quorum is not reached, the General Assembly is convoked for the second call, within 30 (*thirty*) days from the first call with the same quorum required.
- 11.7 Each meeting of the General Assembly shall be chaired by a chairperson, appointed by the Assembly. For the minutes of the meeting, the chairman of the meeting appoints a secretary, who can not be any of the shareholders.
- 11.8 Resolutions of the General Assembly are signed by all participating shareholders.

Article 12

Notice of the General Assembly

- 12.1 The General Assembly is convened at least once a year, within 6 (*six*) months from the end of the financial year for the approval of the financial statements, and also when this is requested in writing by 1 (*one*) or some shareholders who own at least 5% (*five percent*) of the value of the Company's capital ("**Minority Shareholders**"). If the Administrator does not convene the General Assembly within 15 (*fifteen*) days from the submission of the request of the Minority Shareholders, the latter shall have the right to convene the General Assembly themselves, by determining the agenda, time and place of the meeting in accordance with the procedures of set out in the following provisions.
- 12.2 Also, the General Assembly is convened in cases when:
 - i. according to the annual financial statements or interim financial reports, it results or there is a risk that the income realized from the activity of the Company does not cover the required liabilities within the next 3 (*three*) months;
 - ii. The company proposes to sell, or otherwise dispose of assets, which have a value higher than 5% (*five percent*) of the Company's assets, resulting in the latest certified financial statements;

- iii. The Company, within the first 2 (two) years after its registration, proposes to purchase from a shareholder assets, which have a value higher than 5% (five percent) of the Company's assets, resulting in certified financial statements.
- 12.3 The General Assembly convenes at the legal seat of the Company and/or in any other country inside and/or outside Albania.
- 12.4 The meeting of the General Assembly is convened by a written notice sent by registered mail, and/or by e-mail addressed to each of the shareholders. The notice must indicate the agenda, place, date and time of the meeting and will be sent to each shareholder, no later than 7 (seven) days before the date scheduled for the meeting of the General Assembly. The notice must also contain the method of attending the meeting and/or the method of the decision-making.
- 12.5 The announcement of the meeting may provide for a second date for the meeting of the General Assembly, in case the first meeting does not take place according to the announcement due to the lack of quorum defined in this Bylaws.
- 12.6 Notification of the meeting by e-mail (e-mail), is considered received by the shareholder on the date/time indicated in the message of receipt/delivery of the e-mail notification.
- 12.7 The General Assembly is chaired by the person appointed by the majority of the participating partners (hereinafter referred to as the "Chairman of the Meeting").
- 12.8 The Chairman of the Meeting appoints the secretary, who drafts the minutes of the meeting of the General Assembly.
- 12.9 The shareholders can participate in the meeting through electronic means, such as teleconferencing, video conferencing, etc.
- 12.10 The use of electronic means will be realized by taking all the necessary technical measures to guarantee the identification of shareholders, as well as the security of these electronic means. In particular it is necessary that:
- i. The Chairperson of the Meeting has the opportunity to verify and identify the shareholders who are present, to control the progress of the meeting, to count and announce the result of the voting;
 - ii. The Secretary has the opportunity to get acquainted with the facts and events that occurred at the meeting, object of the minutes of meeting;
 - iii. To enable the participation of all those present in the discussions on the agenda, in the review, receipt and distribution of all documents used during the meeting as well as in the voting process on the agenda.
- 12.11 The meeting of the General Assembly in the conditions mentioned in article 12.9 and following of this Bylaws, is considered held regularly in the place where the Chairman of the Meeting is present and the secretary, who makes possible the preparation and keeping of the minutes of the meeting.
- 12.12 The Chairperson of the Meeting will verify the identity of each participating shareholder or their representatives.
- 12.13 The resolutions of the General Assembly as well as the discussions and comments of the shareholders must be reflected in the minutes of the meeting drafted by the secretary of the

meeting. Also, this record must identify the shareholders present and represented, or the shareholders, who have voted in writing. The minutes will be signed by all participating shareholders. The list of shareholders, who have voted is also attached to the minutes, as well as the notification of the convening of the General Assembly which are kept at the legal seat of the Company.

- 12.14 In case the General Assembly cannot consider on the same day all the issues to be discussed, the continuation of the meeting will take place the next day without the need for further notification.

Article 13


Administration

- 13.1 The Company shall be managed by one or more administrators.
- 13.2 The first Administrator of the Company, who shall have a mandate of 5 (five) years, is the following:
- **Mr. Olsi Shtylla**, Albanian citizen, born in Tirana, on 15/06/1975, holder of passport with no. H50915004I;
- 13.3 The Administrator/s is/are appointed by decision of the General Assembly and their appointment can be revoked at any time by the same decision.
- 13.4 The Administrator/s will be natural person/s, without any restriction regarding nationality. The term of the mandate of the Administrator/s will be decided at the moment of the appointment, but in any case, may not exceed 5 (five) years. Notwithstanding this limitation, the duration of the mandate may be renewed upon resolution of the General Assembly.

Article 14

Powers of the Administrator

- 14.1 The Company may be managed and represented by the Administrator, who is responsible for the management of the Company and represent the Company towards third parties, in accordance with the provisions of the present document and the applicable legislation.
- 14.2 The powers and duties of the Administrator regarding the management and supervision of the activity of the Company shall include, but will not be limited, to the following:
- i. to implement the business policies of the Company and the resolutions of the General Assembly;
 - ii. to ensure the compliance of the Company with the laws and accounting standards;
 - iii. to carry out all actions regarding the management of the business activity of the Company;
 - iv. to ensure regular maintenance of the financial and accounting documents of the Company;
 - v. to represent the Company towards third parties;



- vi. to perform all mandatory registrations and publications regarding the Company as required under the legislation in force;
 - vii. to carry out other duties as provided in the law and by this document.
- 14.3 The Administrator/s may exercise all powers and actions, except for those, which by law, these Bylaws or resolutions of the General Assembly are reserved to the General Assembly.
 - 14.4 Any transactions and/or agreements consisting in an indebtedness/exposure of the Company for more than 5.000,00 EUR, additionally to the signature of the administrator shall require also the approval/ratification of the General Assembly.
 - 14.5 The Administrators may delegate part of or all their powers to other persons.
 - 14.6 In the event of appointment of 2 (two) or more administrators, the resolution of appointment of the General Assembly will determine the extent and the matter of execution of the powers, which may be in a jointly or severally manner.

Article 15

Statutory Auditor

If required by law or approved by the General Assembly, the audit of the financial statements and accounting records of the Company shall be entrusted to one or more statutory auditors.

Article 16

Financial year and financial statements

- 16.1 The financial year begins on the 1st day of the month of January and ends on the 31th day of the month of December of each year.
- 16.2 The first financial year begins on the date of registration of the Company with the Commercial Register and ends on the 31th day of the month of December.
- 16.3 The annual financial statements, the inventory, the report of the Administrator and statutory auditor, if there is one, are approved by the General Assembly pursuant to law no. 9901, dated 14.04.2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended.
- 16.4 Approval of the documents relating to the financial statements will take place yearly within 6 (six) months from the end of the financial year.

Article 17

Dissolution and liquidation of the Company

- 17.1 The General Assembly may dissolve the Company upon resolution. The dissolution of the Company will be followed by the liquidation procedure.
- 17.2 The General Assembly will appoint one or more liquidators, determining their powers in compliance with the laws in force.



- 17.3 The Company will continue to exist as a legal entity for the purposes of the liquidation until the completion of the procedure. During such procedure, the wording “*under liquidation*” should follow the denomination of the Company.

Article 18

Distribution of profit

Profits resulting from the annual financial statement shall be distributed to the shareholders, unless the General Assembly resolves otherwise.

Article 19


Applicable law and settlement of disputes

- 19.1 The present document is based on the Albanian legislation and its interpretation, validity and implementation shall be construed and enforced in accordance with the Albanian legislation. The provisions of the law no. 9901 dated 14.04.2008 “*On Entrepreneurs and Commercial Companies*”, as amended, shall apply for matters not regulated by this document.
- 19.2 In case the disputes or controversies that arise out of or relate to the interpretation or execution of this document, the District Court of Tirana shall be competent to settle any claim or dispute.

The present document is drawn in 2 (two) copies in English and Albanian language.


Mr. Olsi Shtylla

Olsi SHTYLLA



ON BEHALF OF ADB IMPIANTI SRL

Mr. Arven Brami



Mr. Dritan Brami

